



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
GYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/OPŠTINSKI SUD ZA PRIKRŠAJE U PRIŠTINI/MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Dep.	DPK / AMP	Nr. Ifaq.	03-2381/12
Dep.		Br. Prot.	
		Prot No.	
		Date	05-07-2012

Nr.regj.37299/11

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, me gjyqëtar Murat Paçaradën dhe sek.juridik Sevdije Gashin duke vendlodur sips Aktvendimit të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje me nr;361/2012,të dt.24.02.2012, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Driart Halit Elshani, për kundërvajtje nga neni 7.parg.1 i sanksionuar me nenin 16 parg.1.2 të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen,dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhurtave të Zyrtarve të Lartë Publik, e në bazë të nenit 73.74.195, dhe 199 të Ligjit mbi kundervajtjet, me dt.**21.06.2012** merrë ketë,

#### A K T V E N D I M

**I PANDEHURI:**Driart Halit Elshani i lindur me 14.06.1979 në Prishtinë,ku edhe tani jeton,Rr”Bledit”nr.6/A,i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike,kryer fakultetin,Drejtoar i Departamentit për Qeverisje Elektronike pranë Ministris së Administratës Publike.

#### Është përgjegjës

Sepse si Drejtëor i Departamentit për Qeverisje Elektronike në Ministrin e Administratës Publike në Prishtinë i zgjedhur në këtë detyrë me datën 07.06.2011,nuk e ka bërë deklarimin e pasuris me rastin e marrjes së funksionit pranë Agjencionit Kundër Korruptionit në afatin e caktuar ligjor,edhe pse ka qenë i njohtuar nga zyrtarja e kësaj ministrie për obligimin që del nga Ligji me nr.03/L-152. Me veprim të këtill ka kryer kundervajtje nga neni 7 parag.1 .i sanksionuar me nenin 16 parg.1.2 të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë,dhe Dhuratave të Zyrtarve të Lartë publik,me nr.03/L-151 andaj për këtë:

#### D E N O H E T

Me gjobë në të holla në shumë prej **500 (pesqind )€**, të cilën gjobë ka përfshirat paguari në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktvendimi merr formen e prerë. Në dobi të tij hyrave gjyqësore të Kosovës,në Prishtinë në xhir. Rrjedh nr. 1000430070000518. Nëse gjobën e shqiptur nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjtë do ti zëvendësohet në denim burgimi në kohëzgjatje prej **30** ditësh duke ju llogaritur **15 €** në një ditë burgimi. Shpenzime të procedures nuk ka pasur.Në emrin të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej **5 EURO**, në afat dhe xhirologari të njëjtë me gjobën. Pagesa e gjobës bëhet në të gjitha bankat e qytetit,kurse paushalli gjyqësorë në arkën e gjykatës Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurit dhe parashtuesit të kërkesës.

#### A r s y e t i m

**Agjencioni Kundër Korruptionit në Prishtinë**,me kërkesën nr.01-4101/11 të parashtuar gjykatës me datën 26.10.2011 për inicimin e procedures kundërvajtëse kundër të pandehurit të përmendur me lartë, për kundravajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Gjykata Komunale për Kundervajtje në Prishtinë duke vepruar sipas kerkesës,e zhvillon procedurën kundervajtse dhe të pandehurin e shpalli faktor dhe e denoi me gjobë prej 500 eurosh,dhe në emrin të paushallit gjyqësor në shumen prej 5 eurosh. I pandehuri Driart Elshani në aftalin e parapar ligjor e atakoj Aktvendimin e Gjykatës Komunale për Kundervajtje në Prishtinë,me arsyetim se aktvendimi nuk është nxirri në menyrë të drejtë,e në të cilin ka shkelje ligjore.

03-2381/12/02  
fig.

2.

Gjykata e Lartë për Kundervaje me dt.24.02.2012,me Aktvendimin me nr:361/2012, e Abrogon Aktvendimin me nr.Regj:37299/11,lënden ja kthenë Gjykatës së shkallës së parë në rivendosje ku e obligon që të ndermerr disa veprime dhe të bënë vertetimin e provave që i pandehuri i thekson në ankesë. Duke veprue sipas udhëzimeve të cekura në Aktvendimin GJ.L.nr:361/2012,me dt.24.02.2012, gjyqtari thirri në seancë të ballafaqimit në mesë deshmitarës Bahrije Spancën,pika kontaktuese në mes Agjencionit Antikorrucion dhe të pandehurit Driart Elshani me datën 29.05.2012.Në kët séanceë deshmitarja Bahrije Spanca disa herë ja perseriti të pandehurit se unë me rastin e marrjes së detyrës nga ana juaj kam ardhur në zyrën e juaj,së pari ja u kam urue detyrën,dhe njëherit ja u kam siell formularët mbi deklarimin e pasurisë së bashku me katalogun e dhuratave,dhe ju kam njohtuar se jeni të obliguar ti plotësoni dhe dergoni formularët,ku njëherit dhe ma ka nënshkrue listen mbi pranimin e këtij dokumentacioni. I pandehuri i thot deshmitarës se nuk më kujtohet se më ke njohtuar si dhe e kontestoj edhe listen gjoja se un e kam nënshkrue.

Gjykata me kujdes shqyrtoj vrejtjet e dhenura nga Gjykata e Lartë sipas Aktvendimit me nr;361/12,të dt.24.02.2012,pastaj ndërmorri të gjitha veprimet procedurale,thirri në séanceë të ballafaqimit të pandehurit dhe deshmitarën pastaj edhe një herë me një kujdesë të madh shqyrtoj kërkesën,deklaratën e të pandehurit deshmitarve,dhe provat të paraqitura nga institucioni përkatës, si dhe shkresat tjera të lendës, dhe erdhi në përfundim se i pandehuri Driart Elashani ka kryer kundervajtjen e cila e ngarkon, dhe se duhet të përgjigjet për kundervajtjen të cilën e ka bërë.

Me rastin e caktimit të lartësisë së gjobës gjyqtari e pati parasysh peshen e kundervajtjes,si dhe rrethanat tjera konform nenit 7 të LMK-së

Duke i marrë prasysht të gjitha këto u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke qenë i bindur se edhe me ketë gjobë mund të arrihet efekti pozitiv i sanksionimit.

Konform nenit 109.al.2 e LMK-së ,caktohen shpenzimet e procedureës

Me sa u tha me lartë u vendos sin e dispozitiv te ketij aktvendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:**Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për kundervajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditë që nga dita e marrjes së aktvendimit e nëpërmes kësaj Gjykate.

#### VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDERVAJTJE NË PRISHTINË.

Gjyqtari  
Murat Paçarada



